

# Të ushqyerit në fazën e tranzicionit - themel ishëndetshëm për fazën e laktacionit

*Përgatitur nga Franz Riegler, Konsulent i Schaumann dhe  
Aksioneri i AUSTRIA Prämix shpk*

Kalimi nga faza e tharjes në lopë qumështore është për çdo lopë një skalitje e fortë. Momenti i lindjes shkakton çrregullime hormonale te lopët. Për këtë periudhë tranzicioni prej afërsisht 3 javë përpara dhe 4 javë pas pjelljes, është shumë e rëndësishme të arrihet një kalim i shëndetshëm për organizmin e lopës.

Shumica e sëmundjeve të metaboloimit të lopëve qumështore si: ethet e qumështit, ketoza , mbetja e placentës, zhvendosja e abomasit shfaqen brenda javës së parë të mëmëzimit si rezultat i problematikës të teknikës së të ushqyerit. Sëmundje të tjera si sëmundjet e thundrave, të cilat nuk janë të evidentueshme në javët e para të mëmëzimit, e kanë gjithsesi zanafillën në këtë periudhë tranzicioni.

Këto sëmundje të lidhura me mënyrën e të ushqyerit, si rezultat i mospërputhjes së racionit ushqimor të rendimentit të qumështit, vijnë me shpenzime për trajtimin mjekësor të kafshëve dhe me skartim të parakohshëm të tyre, të cilat shkaktojnë kosto të konsiderueshme për fermat e qumështit. Analizat e gjakut pas momentit të pjelljes nëpërmjet parametrave të enzimave dhe substrateve tregojnë ngarkesa të metabolizmit.

Tre aspekte kanë rëndësi të veçantë për kalimin e shëndetshëm nga periudha e tharjes në atë të mëmëzimit:

1. Përshtatja e plëndësit për një nivel të lartë energjistik të ushqimit në fazën e mëmëzimit, me objektiv arritjen e një bilanci energjistik pozitiv.
2. Ruajtja e një përmbajtje të lartë të Ca në gjak gjatë pjelljes.
3. Garantimi i imunitetit të lartë të organizmit



## Të ushqyerit në fazën e tharjes

Kërkesat fiziologjike të lopës në këtë fazë tranzitore mund të përmbushen vetëm kur respektohet diferencimi i racioneve ushqimore në të dy fazat (fazën e tharjes dhe laktacionit).

Objektivi i racionit ushqimor për periudhën e tharjes:

- Energji e mjaftueshme për rritjen e embrionit dhe për formimin e gjirit.
- Shmangia e humbjes së peshës trupore
- Parapërgatitja e plëndësit për periudhën e mëmëzimit duke konsideruar nevojën e lartë për koncentrat dhe ushqim energjistik
- Formimi optimal i vileve në plëndës
- Përshtatja e racionit pas pjelljes

Konsumi i ushqimit deri në momentin e pjelljes vjen në rënie, në të njëjtën kohë nevojapër lëndë ushqyese rritet. Prandaj është e rëndësishme ruajtja e konsumit të lartë të racionit ushqimor. Lopët, të cilat konsumojnë shumë parapjelljes, konsumojnë shumë edhe pas pjelljes. Konsumi i ushqimit nxitet nga: përdorimi i ushqimeve me cilësi të lartë, me shijueshmëri të lartë, nga ndryshimi gradual i racionit, nga shmangia e dhjamosjes së lopës dhe jo më pak për nga rëndësia kushte të mira stallore.

Ushqimi 2-3 javë para pjelljes duhet të jetë me cilësi të lartë, ushqim i strukturuar për një konsum LTH (lëndë e thatë) prej 10-12 kg në ditë me nivel energjistik 6,4-6,6 MJNEL për çdo kilogram LTH, 15% proteinë e papërpunuar, mundësisht 18% celulozë ose 300 gr celulozë për çdo 100 kg peshë trupore, vitamina me cilësi si dhe mikroelemente (vitamina A; D<sup>3</sup>; E; B; beta-karoten, selen, zink).

Në fazën e fundit të tharjes, racioni pasurohet dhe me kripëra acidike për të ulur ekuilibrin katione-anione (300 gr për çdo kafshë në ditë). Kjo teknikë e të ushqyerit rekomandohet për një kontroll të mirë të bilancuar të racionit dhe të gjithë përbërësve ushqimorë. Në këto raste synohet një reduktim i nivelit të kationeve me synimin e arritjes së një niveli kalciumi 100-120 gr si dhe 50 gr fosfor në vlerën totale të racionit.

Nëse nuk ofrohet RINDAVIT M, atëherë kjo fazë mund të plotësohet shumë mirë me RINDAVIT VK. Ndyshe nga RINDAVIT MF, furnizimi me Ca në javët e fundit të fazës së tharjes duhet të mbahet në nivele të ulëta.

Plotësimi shtesë me vitamina dhe me substanca për formimin e glukozës arrihet nëpërmjet produkteve energjitike SCHAUMANN si: SCHAUMANN TMR apo RINDAVIT EXTRA.


## Pjellja

Pjellja duhet të mundësohet në një vend të veçuar, të qetë. Direkt pas pjelljes rekomandohet RINDAVIT energjistik në një kovë me afërsisht 15-20 litër ujë të vakët dhe mundësisht të ofrohet që në orën e parë. Pija energjitike RINDAVIT konsumohet me dëshirë, dhe i garanton lopës energji me disponibilitet të lartë, nxit florën e plëndësit dhe çon në një konsum të lartë të lëngjeve direkt pas pjelljes. Rindaviti energjistik i siguron lopës një fillim të mirë të laktacionit.

## Faza e fillimit të laktacionit

Për shkak të rritjes graduale të konsumit të racionit pas pjelljes rezultojnë një bilanc negativ në furnizimin e organizmit me lëndë ushqyese të racionit ushqimor. Si pasojë e këtij kufizimi në konsumin e ushqimit, organizmi reagon në mobilizimin e yndyrave trupore. Në këto kushte rritet niveli i acideve yndyrore në gjak, të cilat nuk përfshihen në ciklin e acidit citrik. Në këtë moment përfshirja e substancave në metabolizëm është e kufizuar pasi sistemi metabolik është i angazhuar në prodhimin e glukozës si burimi më i rëndësishëm i energjisë për lopën në momentin e pjelljes. Acidet yndyrore të çliruara kthehen në trupa ketonik dhe përfundojnë në mëlçi, rrjedhimisht shkaktojnë probleme të metabolizmit si dhe dhjamosje dhe sëmundje të mëlçisë.

Në tabelën 1 dhe 2 paraqitet varësia direkte ndërmjet humbjes së yndyrës trupore në kushtet e bilancit energjistik negativ me problemet e pjellorisë. Lopët me % më të lartë yndyre në mëlçi rezultojnë me nivel më të lartë të acideve të lira yndyrore dhe trupa ketonik. Në këtë rast formohet më pak insulinë dhe si pasojë më pak glukozë. Janë pikërisht këto lopë, të cilat paraqesin simptomat e sëmundjes së shqerit.



Te ushqyerit optimal në fazën e tranzicionit është një nga kushtet e rëndësishme për një lopë të shëndetshme, me rendiment të lartë prodhimi dhe me jetëgjatësi.

Është pikërisht kjo kategori lopësh, e cila edhe disa javë pas pjelljes paraqet vlera më të ulta të hormonit të trupit të verdhë sesa te grupet me vlera më të ulëta të yndyrës në mëlçi. Formimi i pamjaftueshëm i hormonit të trupit të verdhë pason aktivitet dhe cilësi të ulët ovarial.

Konstatimi i afshittë parë është i qartë, sepse korresponon me formimin e folikulave gjatë tharjes, në një kohë kur racioni ushqimor ishte mjaftueshëm i pasur. Ndërsa afshet më vonshme shpesh herë janë të padukshëm pas maturimit të folikulave korresponon me bilanc negativ energjistik dhe shpërbërjen e yndyrave trupore.

**Tabela 1. Efektet e përmbajtjes së yndyrës në mëlçi**

		Përmbajtja e yndyrës në mëlçi	
		e ulët (<20%)	e lartë (20-40%)
acide të lira yndyrore	(mmol/l)	0,58	0,99
Keton	(mmol/l)	0,70	0,95
Glukozë	(mmol/l)	3,17	2,94
<b>Insulinë</b>	<b>(mU/l)</b>	<b>15,60</b>	<b>11,40</b>
<b>Hormoni i trupit të verdhë</b>			
java 2	p.p. (µg/l)	1,59	1,49
java 3	p.p. (µg/l)	1,87	1,52
java 4	p.p. (µg/l)	1,85	1,59

Burimi: Stangassinger, 1990

**Tabela 2. Raporti ndërmjet humbjes së peshës në 5 javët e para pas pjellës dhe pjellorisë**

	Humbja e peshës trupore		
	< 0,5 Pkt	0,5-1,0 Pkt	> 1,0 Pkt
Numri i kafshëve	17	64	12
Ditë deri në evolucionin 1	27	31	42
Dië deri në krijimin e afshit të parë	48	41	62
Ditë deri në inseminimin e parë	68	67	79
Shkalla e konceptimit të inseminimit 1 (%)	65	53	17
Insemenimi për çdo zgjidhje	1,8	2,3	2,3
Inflamacioni i qafës së mitrës (%)	6	22	47

Burimi: Butler & Smith, 1989

Në tabelën 2, duket qartë që kafshët me ndryshim të fortë të kondicionit trupor pas pjelljes shfaqin në mënyrë të dukshme pjellori më të lartë si psh. % e suksesit të inseminimit të parë është vetëm 17 % kundrejt 65 % që është tek grupi i lopëve me humbje të pakët të yndyrave trupore. Vlen të konstatojmë se sa më të ulëta të jenë humbjet e yndyrave në fazën para dhe pas pjelljes aq më pak probleme ka në periudhën në vazhdim.


Duke konsideruar efektin e rëndësishëm të formimit të glukozës për rendimente të larta, për gjendje shëndetësore të lartë dhe për pjellori dhe nga ana tjetër pamundësinë për të plotësuar nevojat me energji në këtë fazë, rekomandohet përdorimi i produkteve energjike si: SCHAUMANN TMR ose TIRSANA, të cilat mbështesin fuqishëm metabolizmin.

Duhet të kihet kujdes, që gjatë të ushqyerit nëpërmjet automateve, rritja e konsumit të koncentratit të mos shkaktojë reduktim të konsumit të ushqimit voluminoz. Teknika TMR (racioni i plotë i përzier) nuk rekomandohet tek mënyra e të ushqyerit me intesitet të lartë, me përjashtim të rasteve kur lopët konsumojnë një sasi të konsiderueshme bari të thatë.

Duke qënë se në çdo kompleks lopësh komponentët e disponueshëm, racioni ushqimor dhe kushtet stallore ndryshojnë nga një fermë në tjetrën, rekomandohet që planifikimi i racioneve ushqimore në këtë fazë të realizohet me specialistin e Schamannit, i cili rekomandon aplikimin e produkteve sipas kërkesës fiziologjike të lopës për një rendiment dhe pjellori të lartë.

### Objektivat në rritjen e viçave:

1. Të rriten viçat të shëndetshëm me anë të mirëmbajtjes optimale dhe furnizimit me ushqim optimal
2. Zhvillimi nga viç i posalindur në ripërtypës përmes nxitjes së hershme të funksionit të preventrikulit.
3. Rritje ekonomike dhe arsyeshme duke përdorur produktet e posaçme.



Rritja e viçave me produkte Schumann- baza për një të ardhme të suksesshme

Sistemitretësiviçittë sapolindur kandryshime të mëdha si nga ana ndërtimore ashtu dhe nga anafunksionale kundrejtviçave ripërtypës. Me rritjen e moshës ndodhin ndryshime thelbësore për sa i përket kapacitetit, funksionit dhe mardhënieve të ndërsjellta ndërmjet organeve të veçanta.

Duke u nisur nga nevojat fiziologjike, fillimisht ushqimi i lëngshëm i viçit sigurohet nëpërmjet një teknike të veçantë ushqyerjes me ushqim të koncentruar dhe bar të thatë. Raporti i abomasumit me proventrikulin në një viç disa ditësh është 75% me 25%. Ky raport ndryshon brenda një viti në 10% me 90 %.

Objektivi është stimulimi i fazës së zhvillimit nga viçi posalindur në ripërtypës. Teknika e të ushqyerit ndikon në mënyrat të ndryshme në zhvillimin e proventikulit (rumen, retikulum, omasum). Ushqimi i koncentruar me përmbajtje të lartë niseshteje (drithëra) nxit rritjen e vileve në stomak. Përshkak të iritimit nga acidetyndyrore (acidpropionik dhe butirik), nga një mur fillimisht i lëmuar i plëndësit zhvillohen vilet në formë të gishtave.

Vetëm kur vilet mbulojnë dhe zmadhojnë mjaftueshëm sipërfaqen e rumenit, atëherë është e mundur të përdoren burime të tjera energjie.

SCHAUMANN ofron produkte të përshtatshme konkretisht për rritjen e viçave (shihni tabelën 1). Krahas produkteve MILCHTRÄNKE, KÄLBERSTARTER dhe barit të thatë furnizimi me ujë luan një rol të rëndësishëm. Viçi ka nevojë në ditë për ujë afërsisht sa 10% e peshës së tij trupore. Një viç 40 kilogramë duhet të pijë në ditë 4 litër ujë. Nëse mendoni, se të ushqyerit me një litër qumësht siguron vetëm maksimalisht 0.9 litër ujë, (minimalisht 100 gramë janë lëndë e thatë) atëherë mund të haset në mënyrë të dukshme një mangësi uji edhe te viçat e vegjël.

Emri i produktit	Karakteristikë	Debit
KALBI-FERM	Magnez , vitamina dhe PROVITA LE	Rritja e fuqisë së trupit, e forcës mbrojtëse, redukon rrezikun e diareisë, përmirëson tretjen
KALBI-START SUPER	Substanca mbrojtëse kundër Coli dhe Rota Virus , PROVITA LE	Ndërtim i sistemit imunitar, stabilizimi i florës së zorrëve
KALBI-LYT	Elektrolite, vitamina dhe frenues diarreje	Elektrolitet mbrojnë kundër dehidratimit, Stabilizimi i metabolizmit të energjisë rregullimi i tretjes
KALBI-PHOSPHORAL SL PRO	Yndyrna, vitamina, mikroelementë dhe PROVITA LE	Furnizimi i plotë nxit rritjen e hershme në ripërtypës, rrit konsumin e ushqimit
KALVICIN 2000 (bzw. KALVICIN PRO)	Minerale, vitamina, substanca ushqyese (apo spore), mikroelementë	Përzjerje minerale dhe substancash për një konsum ushqimi pa problem dhe një rritje më të mirë
KALBI-STARTER-2000	Proteinë, minerale, vitamina, bakteriet e acidit laktik, mikroelementë	Koncentrati i proteinave për prodhimin e ushqimit të viçave lehtësisht të tretshëm
SCHAUMACID Drink	Kombinime acidesh	Për acidifikimin gjatë pirjes së ftohtë të qumështit dhe të ujit

## Një shembull nga praktika -Ferma Steininger, Mühlfeld bei Horn

Kjo fermë ka 90 bokse viçash. Bazuar në fermën Steininger duhet të tregohet, se si arrihet një rritje optimale e viçave.

Vitet e fundit, viçat vendosen në regjim stallor me një peshë mesatare prej 115 kilogramë. Ata mbahen në kashtë. Stalla duhet të pastrohet dhe të disinfektohet pas çdo hyrje. Viçat qëndrojnë këtu minimalisht 6 javë, pastaj zhvendosen në stallë tjetër me komponentë të ndryshëm të racionit ushqimor.

**Pasqyrimi 2:**  
**Përbërja e ushqimit shtesë (Kälberstarter)**

Përbërësit	Pjesa në:%
Elb	49,5
Misër / grurë	20,0
Farë liri	7,0
Bërsi soje 44	19,0
KÄLVICIN 2000	4,0
SCHAUMACID	0,5
Në total	100

## Strategjia e të ushqyerit

- Java e parë e rritjes:  
KALBIMILCHA
- Duke filluar nga java e dytë:  
KALBMILCHA + KÄLBERSTARTER + bar i thatë. Në tabelën 2 përbërja e produktit KÄLBERSTARTER është edukshme.  
Tek produkti KÄLBERSTARTER (jo shumë i imët), vëmendja kryesore i kushtohet dhe cilësisë së STARTER-it që i hidhet në grazhd.  
Duke aplikuar produktin SCHAUMACID ushqimi stabilizohet dhe viçat konsumojnë më shumë. Kjo rritje e konsumit të ushqimit nxit zhvillimin e shpejtë nga viç i vogël në ripërtypës.
- SILAGE përdoret vetëm nëse konsumohet minimalisht 1 kg KÄLBERSTARTER për kafshë në ditë.
- Duhet shmangur përzierja e SILAGE me qumësht, për shkak të rrezikut të lartë të diaresë.  
Për stabilizimin dhe parandalimin e infeksioneve Coli uji i pijshëm apo qumështi acidifikohen me produktin SCHAUMACID.



Duke përshtatur recetat ushqimore me peshën përkatëse, është mundësuar rritja e konsumit të përditshëm nga 1200 gr në 1300 gr. Në të njëjtën kohë duhet të theksohet, që kostot për ushqim nuk janë rritur.

### **Përmbledhje:**

Strategjia e duhur në ushqimin e viçave është çelësi i suksesit në fazat e mëtejshme të rritjes. Sa më herët të fillojnë viçat me konsumin ushqimit të koncentruar, aq më lehtë ndodh rritja. Sipas specialistit të SCHAUMANN KÄLBERSTARTER është mënyra më e mirë për rritjen e viçave. *(DI Gerald Jandrisovits)*